

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

LIGJET DHE TATIMET NË KOSOVË

Zgjidhjet

P4

Nr.

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'IU LEJOHET PREJ
MBIKËQYRËSIT
Do Not Open Until Your Invigilator Allows You to Do So.
2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA
PYETJEVE
All Questions Are Mandatory
3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË
Time Allowed is 3 Hours
4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË
FLETË TË KËTIJ PROVIMI.
Your name should appear nowhere in this test.

Data 24.07.2021

Pjesa A. Detyra me zgjidhje të shumëfishtë (vëtëm një opcion i saktë) Nga 2 pikë secila

1. Fatura në vlerë prej 1298.00 Euro (përfshirë Tvsh) që është kalkuluar gabimisht me norme standarte të TVSh-se prej 18% duhet të korigjohet me normën e reduktuar. Për sa do të jetë vlera e TVSH me e ulete në këtë faturë?
 - a) 198.00 Euro;
 - b) 88.00 Euro;
 - c) 286.00 Euro;
 - d) 110. Euro.

2. Kompania SVision në muajin Maj 2021 ka pranuar një notë debiti nga furnitori. Vlera e TVSH-se në këtë notë debiti është 350 Euro. Kjo notë debiti do të ketë ndikim në deklarimin e TVSH-se për muajin Maj 2021
 - a) 350.00Euro rritja e TVSh se llogaritur;
 - b) 350.00 Euro rritja e TVSH-se se zbritshme;
 - c) 350.00 Euro zvoglim të TVSH-se se llogaritur
 - d) 874.62 Euro zvoglim të TVSH-se se zbritshm.

3. Luna Krasniqi në muajin Prill 2021 ka pasur pagën Bruto (primare) prej 380.00 Euro. Po në këtë muaj Luna Krasniqi ka realizuar të ardhura prej 150 Euro tek punëdhënësi sekondar. Sa janë obligimet tatimore për këtë muaj që i ndalet në burim nga të dy punëdhënësit:
 - a) 15.63 Euro;
 - b) 14.25 Euro;
 - c) 29.93 Euro;
 - d) 26.50 Euro.

4. Luna Krasniqi në muajin Prill 2021 ka pasur pagën Bruto (primare) prej 380.00 Euro. Po në këtë muaj Luna Krasniqi ka realizuar të ardhura prej 150 Euro tek punëdhënësi sekondar. Sa është shuma e kontributit pensional i punëdhënësve dhe i të punësuarit për këtë muaj:
 - a) 53.00 Euro;
 - b) 26.50 Euro;

- c) 19.00 Euro;
 - d) 7.50 Euro.
5. Një biznes individual është i detyruar të kalkulojë obligimin tatimor për "Tatimin Mbi të Ardhurat Individuale" mbi bazën e të ardhurave reale gjegjësisht fitimit real kur ka arritur qarkullimin bruto për vit:
- a) Mbi 30,000.00 Euro;
 - b) Mbi 100,000.00 Euro;
 - c) 50,000.00 Euro;
 - d) Nuk ka detyrim për tatim në të ardhurat reale.
6. Një biznes individual është i detyruar të regjistrohet për TVSH dhe të bëhet person i tatueshëm kur ka arritur qarkullimin bruto për vit:
- a) Mbi 50,000.00 Euro;
 - b) Mbi 30,000.00 Euro;
 - c) Sipas vendimit të ATK ;
 - d) Sipas vendimit të biznesit .
7. Kontributet e dhëna nga tatimpaguesit në fushën e sportit llogariten sipas Ligjit Nr. 05/L -090 për Sponsorizime në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe shuma e lejuar është:
- a) Deri në 30% të fitimit;
 - b) Deri në 10% të fitimit;
 - c) Deri në 30% të tatimit ;
 - d) Deri në 10% të tatimit.
8. Kontributet e dhëna nga tatimpaguesit në fushën e kulturës dhe rinisë llogariten sipas Ligjit Nr. 05/L -090 për Sponsorizime në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe shuma e lejuar është:
- a) Deri në 20% të fitimit;
 - b) Deri në 10% të fitimit;
 - c) Deri në 20% të tatimit ;
 - d) Deri në 10% të tatimit.

9. Sipas ligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, asetet ndahen ne tri grupe. Bazuar në këtë ndarje, rrjeti kabllorë nëntokës i telefonisë i takon grupit:

- a) Grupit të I;
- b) Grupit të II;
- c) Grupit të III ;
- d) Grupit të veçantë.

10. Në rast të një pasurie te paprekshme nuk ka afat përdorimi, sipas ligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave amortizimi do të përllogaritet:

- a) Per 10 vite;
- b) Per 20 vitë;
- c) Me 20% per vit ;
- d) Me 10% per vit.

1. Çdo person, shoqëri ose grup i përbërë nga një ose më shumë persona ose shoqëri mund të themelojë dhe regjistroj një shoqëri tregtare në Kosove.

E saktë

E pasaktë

2. Sipas Ligjin në fuqi Per Shoqerit Tregtare, zyra e regjistrimit te bizneseve duhet të mbajë kopjet origjinale në letër të të dhënave për së paku 10 vite.

E saktë

E pasaktë

3. Asnjë person ose shoqëri tregtare nuk mund të shfrytëzoj ose regjistroj një emër që është:
 - (i) i paligjshëm ose ngatërrues, ose
 - (ii) në pronësi ose kontroll të ligjshëm të një personi ose shoqërie tregtare

E saktë

E pasaktë

4. Për regjistrimin dhe themelimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, themeluesi duhet të nënshkruajë dhe të dorëzojë në Zyrën e Regjistrimit **statutin e shoqërisë** më përgjegjësi të kufizuarne.

E saktë

E pasaktë

5. Sipas Ligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, njëri nga tri kushtet për ndërmarrjet e vogla është numëri i të punësuarve mbi 50 deri ne 250.

E saktë

E pasaktë

6. Sipas Ligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, përgatitja e pasqyrave financiare për ndërmarrjet e mesme behet sipas SNRF të plota..

E saktë

E pasaktë

7. Në kuadër të kërkesave për raportim tek ndërmarrjet e mëdha duhet të jete edhe deklarata e pajtueshmërisë.

E saktë

E pasaktë

8. Ndërmarrjet e vogla duhet të kenë raport rishikimi nga auditori dhe pasqyra financiare të nënshkruar nga kontabilisti i certifikuar.

E saktë

E pasaktë

9. Sipas Ligjit Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, themelimi i njësisë se Hetimeve Tatimore (NjHT) është autorizuar të themelohet për qëllim të hetimit të evazionit tatimor e lidhur me shmangien e detyrimeve tatimore, e parashikuar si vepër penale.

E saktë

E pasaktë

10. Sipas Ligjit Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, çdo person jo-rezident i cili i nënshtrohet çfarëdo tatimi në Kosovë në pajtim me legjislacionin tatimor të Kosovës, do të caktoj një përfaqësues fiskal përpara se të filloj ndonjë veprimtari ekonomike në Kosovë.

E saktë

E pasaktë

11. Çdo tatimpagues, pa marrë parasysh qarkullimin vjetor, përveç mbajtjes së librave dhe regjistrave të parapara me ligj, kërkohet të kryejë regjistrim të mallrave në stoqe në fund të vitit kalendarik. Regjistrimi i tillë, duhet të përfundohet më, apo para, 31 Dhjetor të vitit përkatës dhe të jetë në dispozicion për inspektim me kërkesën e ATK-së.

E saktë

E pasaktë

12. Sipas Ligjit në fuqi Për Tatimin në të Ardhurat Personale interesi në instrumentet financiare të cilat janë të lëshuara apo garantuara nga një Autoritet Publik i Kosovës i paguar tatimpaguesve rezident apo jo rezident është i përjashtuar nga të ardhurat e tatueshme.

E saktë

E pasaktë

13. Sipas Ligjit ne fuqi Për Tatimin ne te Ardhurat Personale ,kur një metodë e regjistrimit të mallit të jetë zgjedhur, ajo metodë do të përdoret për vitin në të cilin është zgjedhur plus së paku për tri periudha tatimore shtesë.

E saktë

E pasaktë

14. Sipas ligjit ne fuqi Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave, humbja tatimore mund të bartet deri në 4 vite të njëpasnjëshme kundrejt të ardhurave të tatueshme të viteve të ardhshme.

E saktë

E pasaktë

15. Një Banke komerciale ne Kosove ka përfituar interes për vitin 2020 ne vlere prej 12 000 Eur nga pagesa qe i ka bere Qeveria e Kosovës ne emër te bono thesarit. Kjo e ardhure është e tatueshme për ketë vit.

E saktë

E pasaktë

16. Sipas ligjit te TVSh-se, **tatimi i llogaritur** kuptojmë- TVSH-në në furnizimet të cilat i bënë personi i tatueshëm ose mallrat që i eksporton personi i tatueshëm.

E saktë

E pasaktë

17. Sipas Ligjit te TVSH-se, **Notë krediti** kuptojmë- dokument i lëshuar për qëllim të një rregullimi nga personi i tatueshëm për pranuesin e mallrave ose shërbimeve, pasi që të jetë lëshuar fatura tatimore ose një dokument që shërben si faturë, ku shuma e TVSH-së së ngarkuar në faturën tatimore ose në dokumentin që shërben si faturë, është me e madhel se obligimi real i TVSH-së për atë furnizim të tatueshëm.

E saktë

E pasaktë

18. Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës është person juridik i pavarur nën mbikëqyrjen e BQK-së i themeluar me qëllimin e vetëm dhe ekskluziv të administrimit dhe menaxhimit të llogarive individuale për pensionet e bazuara në kursime.

E saktë

E pasaktë

19. Sipas Ligjit të Punës në Kosovës, orët e punës ndërmjet orës 22:00 dhe 5:00 numërohen si punë nate.

E saktë

E pasaktë

20. Sipas Ligjit të Punës në Kosovës, I punësuari ka të drejtë të mungoj nga puna me kompensim të pagës pesë ditë në rast të martesës së tij.

E saktë

E pasaktë

Pjesa C. Pyetjet problemore

Problemi 1

10 pikë

M&M sh.p.k. regjistroi blerje gjate 2020 ne shumën Euro 720 000 me norme standarde ; blerje me normën e reduktuar Euro 10,000, shitjet vendore me normën standarde Euro 650 000 ,eksportet Eur 78 000, shitje te përjashtuara pa te drejt kreditimi Euro 305 000 (Vlerat e paraqitura janë pa përfshire TVSH-ne).

Deklarimet mujore per kete vite jan bere duke shfrytëzuar koeficientin e viti 2019 qe ishte 80%.

Kërkohet:

- Sa është koeficientit i TVSH-se se zbritshem per vitin 2020?
- Sa është vlera e TVSH-se se zbritshme për këtë vit?
- Sa është vlera e TVSH-se se llogaritur për këtë vit?
- Cili do te jete rregullimi i TVSH për këtë vit?

Zgjidhje

$$a) PZ = \frac{\text{Furnizimet e tatueshme} + \text{eksporte}}{\text{Furnizimet e tatueshme} + \text{eksporti} + \text{Furnizimet e përjashtuara}} \times 100$$

$$PZ = \frac{650,000 + 78,000}{650,000 + 78,000 + 305,000} \times 100 = 70\%$$

$$b) \begin{aligned} 720,000 \times 18\% &= 129,600 \\ 10,000 \times 8\% &= 800 \\ \text{Totali} &= 129,600 + 800 = 130,400 \end{aligned}$$

$$c) 650,000 \times 18\% = 117,000$$

$$d) \begin{aligned} 129,600 \times 10\% &= 12,960 \\ 800 \times 10\% &= 80 \end{aligned}$$

Total = 12960 + 80 = 13,040 rritje te TVSh se llogaritur me rregullime.

Problemi 2

15 pikë

Kompania ndërtimore H&A Sh.A ka filluar me ndërtim të larte në lagjen Kodra e Diellit me projektin e quajtur "Lule Delli" I cili ka fillua më date 01.03.2018 dhe do të zgjat 34 muaj. Bazuar ne përlllogaritjet fillestare kompania planifikon të ardhura në tersi nga projekti 12,000,000 euro dhe një kosto e tërësishme 8,000,000 euro.

Viti I - Shitje me dy kontrata në vlerë prej 800,000 Euro (300,000 euro dhe 500,000euro).
Pagesat për kontratën e pare secili vite nga 100,000 euro.
Pagesa për kontratën e dyte secili vite nga 100,000 euro

Viti II- Shitje me tre kontrata në vlerë prej 1,500,000 (400,000 euro- K1; 600,000 euro- K2 dhe 500,000 euro -K3)
Pagesat për kontratën e pare 200,000 Euro për vit
Pagesat për kontratën e dyte 200,000 Euro për vit
Pagesat për kontratën e trete 50,000 euro me nënshkrim të kontratës; 50,000 vitin e dytë dhe 400,000 euro viti i tret

Viti i III- nuk ka realizuar ndonjë shitje te re.

Kërkohet:

- Llogaritni obligimin tatimor për secilin vit sipas Ligjit Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, gjegjësisht trajtimi i kontratave afatgjata si pas këtij ligji.
- Përlllogariteni stokun e mbetur në fund te projektit sipas koston së planifikuar.

Zgjidhje

Tatimi nga te ardhurat e Korporatave

Te ardhurate parashikuara	12,000,000.00
Kosto e planifikuar	8,000,000.00
Fitimi I planifikuar	4,000,000.00
Tatimi I planifikuar	400,000.00

Koha e perfundimit te kontrate 34muaj nga data e fillimi te punimeve

a) Fillimi I punimeve	01.Mars 2018	Vlera e kontrates	Te ardhurat vjetore	Kostoja sipas koeficientit
Ne vitin 2018-I		800,000.00	200,000.00	
Koeficineti per vitin e pare	1.67	$200,000/12,000,000*100$		
Te ardhurat e tatushme	200,000.00			
Kosto	<u>133,333.33</u>	$8,000,000 \times 1.67\%$		133,333.33
F.para tat	66,666.67			
Tatimi	6,666.67			
<hr/>				
Viti 2019-II	Shithjet e reja Viti I	1,500,000.00	450,000.00	
			200,000.00	
koeficient	3.75	$450,000/12,000,000*100$		
Koeficient Viti I	1.67			
Total	5.42			
Te ardhurat e tatushme	650,000.00			
Kosto	<u>433,600.00</u>	$8,000,000 \times 5.42\%$		433,600.00
Fitimi P.T	216,400.00			
Tatimi	21,640.00			
<hr/>				
Viti 2020-III	Shithjet e reja Viti I		-	

		400,000.00	
	Viti II		1,050,000.00
Koeficienti per vitin e trete	12.08	$1,450,000/12,000,000*100$	
Te ardhurat	1,450,000.00		
Kosto	<u>966,400.00</u>		966,400.00
Fitimi	483,600.00		
Tatimi	48,360.00		

TOTAL SHITJET TOTALE		2300000	
KOSTOJA TOTALE			1,533,333.33
FITIMI PARA TATIMI		766666.6667	
TATIMI		76666.66667	

Pjesa e mebtur

b)

Kosto e planifikuar	8,000,000.00
Kosto e njohur	(1,533,333.33)
Soku I mbetur	6,466,666.67

Problemi 3

15 pikë

Kompania VISION shpk me seli në Prishtinë kryen disa aktivitete ekonomike tregtare në tërë territorin e Kosovës. Gjatë muajit Prill 2021 ka patur këto transaksione:

- i. shitjet brenda vendit me norme 18% - shuma e tatushme 100,000 Euro;
- ii. shitjet brenda vendit me norme 8% - shuma e tatushme 50,000 Euro
- iii. shpenzime për shërbime konsulence 4,200 Euro;
- iv. importe nga jashtë (mallra për qëllime tregtimi) në vlerë 36,000 Euro, pluse taksa doganore 10%/ (I takojnë normës standarde);
- v. importe nga jashtë (mallra për qëllime tregtimi) në vlerë 16,000 Euro, pluse taksa doganore 10%/ (I takojnë normës së reduktuar);
- vi. shpenzimet e derivateve 2,800 Euro;
- vii. import i një mjet transportues i cili nevojitet për shpërndarjen e mallit në vlere 22,000 Euro, shtese 10% takes doganore dhe 500 euro akcize;
- viii. shpenzime për agjentet e shpërndarjes 3,000 euro;
- ix, shpenzime të qirasë neto 2,000 euro;
- ix. notë kreditore e lëshuar me norme 18% vlera 2,000 Euro shuma e tatueshme;
- x. notë debitore e pranuar me norme 8% vlera 1,000 Euro shuma e tatueshme;
- xi. shpenzime të rrymës dhe ujit të cilat i nënshtrohen normës së reduktuar prej 250 Euro (shuma e tatueshme).

Po ashtu gjatë këtij muaji ka pranuar shërbime të nga jashtë vendit në vlerë prej 1,800Euro (ngarkesë e kundërt për shërbime).

Vlerat e paraqitura janë pa përfshire Tvsh-në.

Kërkesa:

Përpiloni ekstraktin e deklaratës së Tvsh-së sipas renditjes se sa ka pagesë/kreditim për muajin 04/2021.

Zgjidhje

Kërkesa për rimbursim	[70]	
Kreditimi I tvsh-së për muajin pasues 71=(69-70)	[71]	
TVSH që duhet te paguhet 72=(30-67-68)>0	[72]	6,922.40

	Vlera	Norma doganore	taksa dog,	Akciza	Baza per TVSh
35	36000	10%	3600		39600
37	16000	10%	1600		17600
39	22000	10%	2200	500	24700
		shpenzime derivate	qiraja		
43	4200	2800	2197.8		9197.8
			2000/91%		

Problemi 4

7 pikë

EKO sh.p.k. për periudhën 05/2020ne baze te regjistrimeve ne librat e TVSH kishte një obligim për TVSH ne vlere prej 5,200 Eur.

Kompania deklaroi me 5 Shtator 2020 dhe beri pagesën ne muajin Prill 2021 se bashku me gjokat dhe interesin përkatës.

Kërkohet:

Sa janë gjokat dhe interesi për këtë vonese qe kompania pagojë duke u bazuar ne lehtësirat qe parasheh Ligji mbi procedurat dhe Administratën Tatimore ?

Zgjidhje

1.Gjoka për mos dorëzim te deklaratës ne kohe 5% ne muaj (4 muaj)	5,200 * 20% = 1,040	25%= 260
2. Gjoka për mos pagese në kohe 1% muaj (7 muaj)	5,200* 7% = 364	25%= 91
2..Interesi 0.65% ne muaj (12 muaj)	-	5,200*7.8% = 405.60
TOTALI		756.60

Problemi 5**5 pike**

Kompania ICMA Sh.p.k ka fillu veprimtarin ne vitin 2019 me date 31.12.2019 kishte gjendje te aseteve si me poshte:

Kostoja

Grupi I

Ndërtesa - 280,000

Grupi II

Kamion- 45,000

Buldozeri- 42,200

Grupi III -

Makine Prodhimi - 120,000

Kërkohet:

Përlllogariteni zhvlerësimin tatimor për secilin aset.

Zgjidhje

Zhvlerësimi Tatimore

Grupi I

Ndërtesa - $280,000 \times 5\% = 14,000$

Grupi II

Kamion - $45,000 \times 20\% = 9,000$

Buldozeri- $42,200 \times 20\% = 8,400$

Grupi III

Makine Prodhimi - $120,000 \times 10\% = 12,000$

Totali

Problemi 6

8 pike

Kompania Merkator punësuar znj. Luna ne cilësinë e konsultantes. Data e fillimit të punës se ti ka qen 1 Qershori 2020, paga i saj mujore është 2,200 Eur.

Znj.Luna ju ka angazhuar ju ne cilësinë e këshilltarit tatimore qe te plotësohet deklaratë përfundimtare te saj si dhe duke përlogaritur tatimin e mbajtur ne burim nga Merkatore.

Kërkohe:

Llogaritni detyrimin e tatimit në paga për vitin 2020 të znj. Luna; diferencën e tatimit te mbajtur ne burime dhe obligimit tatimore si dhe detyrimin për KP.

Zgjidhja

KP- $2,200 \times 7 = 15,400 \times 5\% = 770 + 770 = 1540$

I mbajtur ne burim

Paga $2,200 \times 5\% = 110$

Baza per tatim $2,200 - 110 = 2,090$

0- 80 =0

80-250 - $170 \times 4\% = 6.8$

250-450 - $200 \times 8\% = 16$

450 -2090 - $1640 \times 10\% = 164$

Total $186.80 \times 7 = 1,307.60$

Vjetore

Te ardhurat $2,200 \times 7 = 15,400 \times 5\% = 770$

Baza per tatimi $15,400 - 770 = 14,630$

0-960 = 0

960 - 3000 - $2,040 \times 4\% = 81.60$

3000-5400 - $2,400 \times 8\% = 192.00$

5400-14,630 - $9,230 \times 10\% = 923.00$

Total 1,196.60

Obligimi tatimor = 1,196.60

Tatimi ne burim = 1,307.60

Rimbursim = 111